

Emri i Lëndës : Mikroekonomi							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
CMP 213	B	Vjeshtë	3.00	0.00	1.00	3.00	5.00
Lektori		Eduina Maksuti, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Kjo lëndë ka për qëllim t'u mësojë studentëve parimet e mikroekonomisë, funksionimin e mekanizmit të tregut, analizën e kërkesë-ofertës, elasticiteti dhe aplikimet e tij në praktikë. Po kështu do të analizohet ndërveprimi kërkesë-ofertë dhe politikat qeveritare, surplusi prodhues konsumator, efienca e tregut. Gjithashtu studentëve do t'u jepen bazat e funksionimit të ekonomisë së sektorit publik qe përfshin te mirat publike dhe burimet e përbashkëta, ngritja e sistemit të taksave, sjellja e firmës në strukturat e ndryshme të tregut, të tilla si tregjet konkurruese, monopoli, oligopoli, duke hyrë më në detaje tek tregu i punes dhe tregu kapital.					
Objektivat		Objektivi kryesor i kësaj lënde është t'i mësoje studentëve parimet dhe metodat themelore të teorisë moderne mikroekonomike. Gjithashtu ilustron dobinë e këtyre parimeve, metodave dhe modeleve për studimin e problemeve aktuale mikroekonomike. Për të kuptuar jetën ekonomike dhe për të analizuar sjelljen e konsumatorëve.					
Konceptet Kryesore		Mikroekonomi,oferta, kërkesa, konsumator, prodhues, efikasiteti i tregut, kostot e taksimit, eksternalitetet, mallrat publike.					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje: Ky leksion jep një shpjegim të lëndës në përgjithësi dhe sqaron dhjetë parimet e shkencës ekonomike. Do trajtohet vendimmarrja vetjake dhe kompromiset që përballen njerëzit, kostoja marxhinale, dobia e tregtisë, ndërhyrja e qeverisë në përmirësimin e rezultateve të tregut. (fq. 39-60, Kapitulli 1, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)						
2	Të mendosh si ekonomist. Në këtë leksion do diskutohet qasja e ekonomistëve ndaj çështjeve si një shkencëtar. Do shpjegohen skema e qarkullimit dhe kufiri i mundësive të prodhimit, si dhe përkufizimet e mikroekonomisë dhe makroekonomisë. (fq. 61-94, Kapitulli 2, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)						
3	Ndërvaresia dhe dobitë nga tregtia. Këtë javë do shpjegohet se si tregtia dhe ndërvaresia lejon çdo njeri të jetë në një pozitë më të mirë. Gjithashtu do trajtohet epërsia absolute dhe epërsia relative në prodhimin e një malli. (fq. 95-113, Kapitulli 3, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)						
4	Forcat e tregut të ofertës dhe të kërkesës. Në këtë leksion do shpjegohet përdorimi i ofertës dhe kërkesës për të analizuar tregjet konkurruese. Do shihen paraqitjet grafike të vijës së ofertës dhe kërkesës, do diskutohen mallrat zevëndësuese dhe bashkëplotësuese. (fq. 115-146, Kapitulli 4, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)						
5	Elasticiteti dhe zbatimi i tij. Në këtë leksion do shpjegohen koncepti i elasticitetit, elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin, elasticiteti i ofertës lidhur me çmimin, si dhe paraqitja grafike e tyre. (fq. 147-176, Kapitulli 5, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)						
6	Oferta, kërkesa dhe politikat qeveritare. Këtë javë do qartësohen konceptet çmim tavan dhe çmim dysHEME, dhe ndikimi që ato kanë mbi rezultatet e tregut. Gjithashtu do trajtohen taksat, si një instrument i rëndësishëm i politikave, si dhe shpërndarja e barrës së taksës. (fq. 177-202, Kapitulli 6, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)						

7	Konsumatorët, prodhuesit dhe efikasiteti i tregjeve. Në këtë leksion do njihemi me koncepte si teprica e konsumatorit, teprica e prodhuesit, shpërndarje e burimeve, efikasitet, drejtësi. Do diskutohet paraqitja grafike e tepricave të konsumatorit dhe prodhuesit. (fq. 203-226, Kapitulli 7, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)
8	Provimi gjysmëfinal
9	Zbatim kostot e taksimit. Në këtë leksion do shpjegohet si ndikon një taksë mbi pjesëmarrësit në treg, humbja neto dhe dobietë nga tregtia, përcaktorët e humbjes neto. (fq. 227-246, Kapitulli 8, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)
10	Zbatim: tregtia ndërkombëtare. Ky leksion do trajtojë tregtine ndërkombetare, çmimin botëror dhe epërsine relative, fituesit dhe humbësit nga tregtia. Gjithashtu do qartësohen efektet që kanë tarifatat dhe kuotat e importit. (fq. 247-276, Kapitulli 9, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)
11	Eksternalitetet. Këtë javë do jepet një shpjegim i eksternaliteteve dhe efikasitetit të tregut, eksternalitetet negative dhe pozitive, si dhe zgjidhjet private për eksternalitetet. Do trajtohen politikatat publike që ndërmerren ndaj eksternaliteteve. (fq. 277-301, Kapitulli 10, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)
12	Mallrat publike dhe burimet e përbashkëta. Në këtë leksion do flitet për katër llojet e mallrave; mallra private, monopole natyrore, mallra publike dhe burime të përbashkëta, duke dhënë një shpjegim më të thellë të dy llojeve të fundit. (fq. 303-325, Kapitulli 11, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)
13	Kompozimi i sistemit të taksave. Në këtë leksion do shpjegohen sistemet e ndryshme të taksave. Do diskutohen tema si; taksat dhe efikasiteti, barra administrative, taksat dhe drejtësia, duke marrë në studime shembuj të ndryshëm nga ekonomia botërore. (fq. 327-357, Kapitulli 12, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)
14	Kostot e prodhimit. Këtë javë do shpjegohet çfarë janë kostot, kostot eksplicite dhe implicite. Do diskutohet për prodhimin dhe kostot, funksionin e prodhimit, produktin marxhinal. Do jepen paraqitje grafike të matjeve të ndryshme të kostove. (fq. 359-387, Kapitulli 13, Ekonomiksi; Mikroekonomia; Gregory Mankiw & Mark Taylor, UETPress, 2010.)
15	Përsëritje
16	Provimi Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Ekonomiksi, Mikroekonomia, M. Gregory Mankiw & Mark. P. Taylor	
Referenca të tjera	
• Materiale të ndryshme studimore shkencore të cilat do të sugjerohen nga lektori i lëndës.	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët mësojnë termet themelore të ekonomisë
2	Studentët fitojnë aftësi në kuptimin e koncepteve lidhur me tregun.
3	Studentët kuptojnë vendimmarrjen e konsumatorëve dhe prodhuesve në një treg.
4	Studentët fitojnë aftësi mbi mendimin kritik të situatave të ndryshme nga një perspektivë ekonomike.
5	Studentët fitojnë aftësi mbi shprehjen grafike të kërkesës dhe ofertës.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	9	9
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00